



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly**

LEGJISLATURA V

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 28.

Prishtinë, më 8.12.2015 në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Zhivković, Agim Kikaj, Milka Vuletiq, Sasha Milosavljeviq, Slavko Simiq, Qerim Bajrami, Danush Ademi dhe Veton Berisha .

Munguan: Agim Çeku, Mufera Shinik, Fisnik Ismaili dhe Rustem Berisha.

Pjesëmarrës të tjerë në mbledhje : Ardiana Gashi- përfaqësues nga OSBE-ja, Zijush Ahmeti - konsulltant i Sekretariatit të KKK dhe Celal Iliaz, nga Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Prica-Tishma, koordinatorë dhe Drita Çarkaxhiu, zyrtarë e lartë ligjore.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Zhivković**, kryesuese e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua, ky rend i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, me amendamente të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-221, nr. 04/L-116 dhe nr. 04/L-194, me amendamente të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L-327, me amendamente të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa;**

1. **Miratimi i rendit të ditës;**

Kryesuesja, konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa;

Kryesuesja, bëri të ditur se Komisioni sot ka marrë raportin me amendamente në Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, të Komisionit FunkSIONAL. Gjatë shqyrtimit të raportit ajo propozoi, që secili amendament të votohet veçmas.

Diskutoi lidhur me amendamentin 4, ku bëhet fjalë për ndarjen buxhetore për komunitete në kuadër të Zyrës për Komunitete dhe Qeverisë. Sa i përket mjetet buxhetore për subvencioneve dhe transfereve, nuk është e arsyeshme që të merren mjetet vetëm nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, por duhet të jenë të përfshira paralelisht edhe ministrinë tjera, të linjës.

Danush Ademi, theksoi se amendamenti 4, është propozuar nga GP 6+ dhe se ka marr miratimin nga Komisioni FunkSIONAL. Riformimi i nenit flet për shfrytëzimin e mjeteve për komunitete, ku buxheti do të merret nga Zyra për Komunitete dhe Qeveria. Si kërkesë e jona mbetet që me rishikim të buxhetit të vitit 2016, të merren mjetet buxhetore edhe nga ministrinë e linjave tjera

Agim Kikaj, tha se përkrah propozim amendamentin 4, të Komisionit FunkSIONAL. Ai veçoi se ky amendament nuk amnistion asnjërin nga ministrin e linjës, që të parashohin në projektet e tyre përfitime financiare për komunitetin jo shumicë, gjegjësisht komunitetin jo serb. Prandaj, Qeveria në bashkëpunim me Ministrinë për Komunitete e harton programin për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve.

Veton Berisha, shprehu qëndrimin e tij se përkrah projektbuxhetin e vitit 2016, në parim. Theksoi se amendamenti 4, parasheh menaxhimin e ndarjes buxhetore për komunitete nga Zyra për Komunitete dhe Zyra e Kryeministrit. Ishte i pajtimit me kriteret e planifikuara për shpërndarje të subvencioneve dhe transfereve, me detyrim që projektet kapitale të shfrytëzohen në pajtim me programin për komunitete nga ana e Qeverisë. Berisha tha se ndarja e mjeteve për kategorinë e komuniteteve, nuk mund të bartet në të gjitha ministrinë sepse praktikisht është e përealizueshme një ndarje e tillë buxhetore. E gjithë kjo, se Qeveria ka plan zhvillimor për qytetarët e Kosovës, ku përfitues do të jetë edhe komuniteti jo shumicë. Ne mund të propozojmë të angazhohet Ministria e Bujqësisë, e cila ka linjën buxhetore për ndarje të subvencioneve dhe transfereve, me qëllim të përkrahjes së komuniteteve.

Sasa Milosavljeviq, mendon se jemi të vonuar të ofrojmë propozim amendament të ri, pasi nesër do të bëhet leximi i dytë i projektligjit për buxhet për vitin 2016, në Kuvend. Sa i përket ndryshimit dhe plotësimit të amendamentit 4, të participojnë edhe ministrinë tjera, në këtë rast duhet të jemi të kujdesshëm që të mos përzihen kompetencat, përveq që lejohet me ligj.

Danush Ademi, pas diskutimeve, doli me propozim që të plotësohet amendamenti 4, me tekst, për kategorinë e subvencioneve dhe transfereve, të jetë përgjegjëse edhe Ministria për Bujqësi dhe Ministria e Kulturës.

Veton Berisha, pati vërejtje në amendamentin 15, ku bëhet fjalë për ndërtimin e rrugëve të reja në fshatrat e Pejës, ku me projektbuxhet është ndryshuar shuma prej 700.000 euro. Lidhur me këtë çështje, kërkoi të ketë përkrahje më të shtuar për komunitetin të cilit ai i përket. Ai doli me propozim, që në tërë tekstin e raportit të Komisionit FunkSIONAL, shkurtesa “RAE”, të ndryshohet dhe të plotësohet me emërtim të plotë “Komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptian” në gjuhën shqipe.

Qerim Bajrami, dha sqarime se ka propozuar amendamentin 61 me tekstin si në vijim: Nga organizata Buxhetore, Universiteti i Prishtinës nga kategoria ekonomike “Mallra dhe shërbime” zvogëlohet shuma prej 70.000 euro dhe transferohet në organizatën buxhetore “Universiteti i Prizrenit” në kategorinë ekonomike “Paga dhe mëdijtje”.

Konsideron se mos përfshirja e nevojshme buxhetore për Univerzitetin e Prizrenit, paraqet ngecje të madhe për studentët e komunitetit pakicë. Vërejtja e tij konkrete ishte se i njëjti amendament nuk ka marr përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL për buxhet dhe financa. Njëherit kërkoi që ky amendament të marr përkrahjen e plotë të komisionit tanë.

Nëse nuk arrihet konsensus i përbashkët, me këtë rast do të abstenson votimin e projektligjit për buxhet, të vitit 2016.

Kryesuesja, theksoi se me projektbuxhet të vitit 2016, buxheti i MKK-s është i vogël me ç'rast nuk mund të përballojë si ministri e vetme ndarjen buxhetore për subvencione dhe transfere për të gjithë pjesëtarët e komunitetit jo shumicë. Ajo përsëriti të njëjtën kërkesë, që për ndarjen e këtyre fondeve të jenë përgjegjëse të gjitha ministrinë, e linjes.

Në kuadër të diskutimeve, kryesuesja e hodhi në votim amendamentin 4, të Komisionit FunkSIONAL dhe i njëjti nuk merr votat e mjaftueshme për miratim.

Komisini, pas shqyrtimit të Projektligjit dhe Raportit me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, nxori këtë:

Rekomandim

- I. Projektligji nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republokës së Kosovës për vitin 2016, nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. 1. Komisioni shqyrtoi amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL dhe nuk ka përkrahur amendamentin 4, 60 i propozuar nga Grupit Parlamentar 6+
2. Rekomandohet propozimi për ndryshim, si në vijim:

Amendamenti 1

Pas nenit 9, shtohet neni i ri 10, me tekstin si në vijim:

- I. Buxheti i ndarë për Zyrën për Komunitete në Zyrën e Kryeministrit, kategoria subvencione dhe transfere dhe buxheti i ndarë për Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport, Ministrinë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, Ministrinë për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, Ministrinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Ministrinë për Shëndetësi, për projektet kapitale, shfrytëzohet në pajtim me Programin për komunitete të miratuar nga Qeveria.
- II. Komisioni ka shqyrtuar amendamentin 61, i propozuar nga deputeti Qerim Bajrami dhe i njëjti është përkrahur.
- III. Komisioni ka shqyrtuar amendamentin 62, të grupit të deputetëve: Adem Salihaj, Milazim Haliti, Blerim Granica, Synavere Rysha, Ali Sadriu, Danush Ademi dhe i njëjti është përkrahur.

Amendamenti 2

Në tekstin e amendamentit 55, të Komisionit FunkSIONAL, shkurtesa “ RAE”, të zëvendësohet me emërtim të plotë “ Komuniteti Rom, Ashkali dhe Egjiptian” në gjuhën shqipe.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-221, nr. 04/L-116 dhe nr. 04/L-194, me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa;

Kryesuesja, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.05/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-221, nr. 04/L-116 dhe nr. 04/L-194, dhe kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohet, nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandimin, i cili do t'i dërgohet Komisionit Funksional.

Me që nuk pati vërejtje në Projektligj dhe Raportin e Komisionit Funksional me amendamente të propozuara, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr.05/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.03/L-221, nr. 04/L-116 dhe nr. 04/L-194 dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
 - II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L-327, me amendamente të Komisionit Funksional për Buxhet dhe Financa;**

Kryesuesja, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, me raport amendamente të Komisionit Funksional dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Meqë nuk pati vërejtje në Projektligj dhe Raportin e Komisionit Funksional me amendamente të propozuara, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- III. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- IV. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 15:30

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Jasmina Zhivković